



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
KËSHILLI DREJTUES

VENDIM

Nr. 8, datë 24.04.2020

PËR
“MIRATIMIN E RAPORTIT TË VEPRIMTARISË SË AUTORITETIT TË
KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE (AKEP) PËR VITIN 2019 ”

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), me pjesëmarrjen e:

Z.	Tomi Frashëri	Kryetar
Znj.	Ketrin Topçiu	Anëtar
Znj.	Edlira Dvorani	Anëtar
Znj.	Xhoana Lilaj	Anëtar

dhe sekretare Znj. Hasime Ferati, në mbledhjen e datës 24.04.2020, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr.9918, datë 19.05.2008, “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe Rregullores së Brendshme të Funkcionimit të Këshillit Drejtues të AKEP, miratuar me Vendimin nr.7 datë 16.02.2017 të Këshillit Drejtues të AKEP, të ndryshuar, shqyrtoi çështjen me objekt:

“Miratimin e Raportit të veprimtarisë së Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) për vitin 2019”

BAZA LIGJORE:

1. Neni 9, pika 1 e nenit 114, dhe pika 1 e nenit 115, të Ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, (*ligji nr. 9918/2008*);
2. Neni 8 i ligjit 46/2015 “Për shërbimet Postare ne RSH” (*ligji nr. 46/2015*);
3. Vendim i Kuvendit të RSH nr.134/2018 “Për miratimin e manualit të monitorimit vjetor dhe periodik” (*Vendimi i Kuvendit nr.134/2018*);
4. Rregullore e Brendshme “Për Funkcionimin e Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare”, miratuar me Vendimin nr.7, datë 16.02.2017 të Këshillit Drejtues të AKEP, e ndryshuar (*Rregullore nr.7/2017*);

K Ë SHILLI DREJTUES:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor të përbërë si më poshtë:

1. Projekt-raporti i Veprimtarisë së AKEP për vitin 2019;
2. Relacioni shpjegues mbi projekt-vendimin (**Relacioni**);
3. Projektvendimi i Këshillit Drejtues për miratimin e “Raportit të veprimtarisë së Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) për vitin 2019”.

V Ë R E N:

1. Projekt-raporti i paraqitur pasqyron në mënyrë të plotë dhe korrekte veprimtarinë e AKEP për vitin 2019 dhe është hartuar bazuar në raportimet e bëra nga secila drejtori e AKEP mbi veprimtarinë e kryer, gjithashtu përmban edhe çështjet e detyrueshme për raportim të përcaktuara nga Kuvendi i RSH lidhur me institucionet në monitorim.
2. Përmbajtja e Projekt-raportit përmbush kërkesat ligjore të përcaktuara në:
 - i. Nenin 9, të ligjit nr.9918/2008;
 - ii. Nenin 8, të ligjit nr.46/2015;
 - iii. Vendimin e Kuvendit nr.134/2018;
 - iv. Rregulloren e Brendshme të AKEP.

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Këshilli Drejtues pasi e gjen projekt-raportin në përputhje me kërkesat ligjore, në mbështetje të pikës 1 të nenit 114 , të pikës 1 të nenit 115, të ligjit nr.9918/2008 si dhe Rregullores së Brendshme,

V E N D O S I:

1. Të miratojë “Raportin e veprimtarisë së Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) për vitin 2019”, sipas dokumentit bashkëlidhur;
2. Të dërgojë “Raportin e veprimtarisë së Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) për vitin 2019”, në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, dhe një kopje e tij, t’i dërgohet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë;
3. Ky vendim publikohet në faqen e internetit të AKEP, së bashku me “Raportin e veprimtarisë së Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) për vitin 2019” ;
4. Ngarkohet Kabineti për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetar

Tomi FRASHËRI

Anëtar

Edlira DVORANI

Anëtar

Ketrin TOPÇIU

Anëtar

Xhoana LILAJ